



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAMËZ

Data _____.____.2026

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: ***“Blerje bojra per printer dhe fotokopje”***

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): **30190000-7**

Furnizime dhe pajisje te ndryshme zyre

“Toner per printer lazer/makina fax”- 30125110-5

“Toner për makinat fotokopjues”- 30125120-8

VLERA E FONDIT LIMIT: ***6,250,000 (gjashtë milionë e dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë pa TVSH.***

Në bazë të nenit 21, pika 2, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Kamëz ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Për këtë procedurë prokurimi, bazuar në VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, me urdhër nr.6243 datë 22.07.2024, është ngritur grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike dhe preventivin për tenderin.

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

Argumentimi: Ky kriter u vendos bazuar në nenin 82 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar, dhe nenin 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, në të cilën është e përcaktuar se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.” Ky kriter u vendos sipas nenit 83 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, në të cilën është e parashikuar se: Pika 1 Neni 83: Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël. Pika 2 Neni 83: Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit: a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përlllogaritur të kontratës; b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës, si dhe në nenin 30 të VKM nr.285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

Referuar pikës 1 të shtojcës 7, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 8.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe shtojcës 8 të DST-së.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2023-2024-2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 40%** e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet. *Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar; nenin 43 dhe nenin 55 pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit

nr.29/2023“Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomik ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomike dhe financiare për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor. Referuar sa më sipër duke qënë se vlera e fondit limit është në kufirin e vlerës që i përket llojit të procedurës “Procedurë e hapur e thjeshtuar” edhe vlera e kërkuar për xhiron do të vendoset konform kësaj procedure prokurimi referuar dispozitave ligjore si më sipërcituar. Kjo vlerë është kërkuar duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorit ekonomik, të cilët duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.3 Kapaciteti teknik dhe profesional:

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizime të ngjashme në një vlerë jo më të vogël se 20% e vleres se perlllogaritur te kontrates, qe prokurohet dhe qe eshte realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes se njoftimit te kontrates.

Per kete pike Operatori Ekonomik duhet te paraqese një nga dokumentat e meposhtem:

a) Ne rastin e pervojes se meparshme te realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet te paraqese vertetime te leshuara nga nje ent publik ose fatura tatimore te shitjes, ku të jenë shënuar saktë datat, shumat, sasi të e mallrave të furnizuara,

ose

b) Në rast se pervoja e mëparshme është realizuar me sektorin privat, si deshmi do të pranohen vetëm fatura tatimore shitje, te plotesuara sipas kerkesave te legjislacionit ne fuqi, dhe te deklaruar ne organet tatimore, ku të jenë shënuar saktë datat, shumat, sasi të e mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4 të nenit 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” si dhe pikes 4/b, nenit 55 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar). Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë ne vlerën jo më pak se 20% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës për kontratat e ngjashme është përcaktuar referuar bazës ligjore sa më sipërcituar dhe vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet. Me anë të këtij kriteri vërtetohet se operatorët ekonomikë kanë përvojë të mëparshme për procedura të ngjashme me objektin që prokurohet si dhe kanë përmbushur me sukses kontratën për të cilën janë shpallur fitues. Kjo tregon se operatori ekonomik është vazhdimisht i angazhuar në treg me kontrata furnizimi, çka rrit

besueshmërine te Autoriteti Kontraktor se në rast shpallje fitues, ekzekutimi i kontratës do të jetë në përputhje me përcaktimet e DST, dispozitat e kontratës dhe planit të zbatimit të kontratës. Për shkak të rëndësisë që ka vet Autoriteti Kontraktor, llojit të mallit objekt prokurimi, i rëndësishëm për funksionimin e automjeteve të Prokurorisë së Posaçme, me qëllim që të hyjmë në marrëdhënie kontraktuale me operatorë ekonomikë seriozë në treg, me performancë të mirë e të vazhdueshme, aplikojmë marzhin maksimal të vlerës së parashikuar.

2.3.2 Operatori ekonomik pjesmarrës duhet të paraqesë Certifikatë ISO 9001:2015 ose ekuivalente për menaxhimin e cilësisë. Certifikatat duhet të jenë të vlefshme në momentin e zhvillimit të procedurës së prokurimit.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme bazohet në nenet 77 dhe 79 të LPP, nenit 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", është kërkuar kjo certifikatë me qëllim që operatorët ekonomikë që do të zbatojnë kontratën të jenë certifikuar në sistemin e menaxhimit të cilësisë. Certifikata duhet të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Nisur nga rëndësia, volumi i kontratës, rëndësia e AK (Autoritetit kontraktor) të përfshirë në këtë procedurë është e rëndësishme me qëllim realizimin me sukses të kësaj procedurë që operatori pjesëmarrës të provojnë se ka një sistem të menaxhimit të cilësisë, pra të demonstrojnë aftësinë e tij për të ofruar vazhdimisht produkte që plotësojnë kërkesat e konsumatorëve, pra të AK-së dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullative me qëllim të rrisë kënaqësinë e konsumatorit nëpërmjet zbatimit efektiv të sistemit, duke përfshirë proceset për përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit dhe sigurimin e konformitetit ndaj klientit pra Ak-së .*

2.3.3 Operatori ekonomik të paraqesë një Deklaratë e cila të përmbajë:

- Në momentin e dorëzimit të mallit tek autoriteti kontraktor, malli do të shoqërohet me deklaratën e cilësisë, origjinës dhe garancisë.

Shënim: Tonerat/bojërat duhet të evidentohen nëpërmjet part/number-it (Kodit) përkatës, pasi është elementi kryesor dallues i përcaktuar në datasheet-in dhe katalogun e printerit apo fotokopjes për të cilën nevojitet. Tonerat/bojërat për printerat dhe fotokopjet ose pajisje të tjera, duhet të jenë origjinale ose ekuivalente, me vulë origjinaliteti, të pahapura, jo të rimbushura dhe jo të ricikluara. Emri i kompanisë prodhuese/marka, duhet të jetë e stampuar dhe e njëjtë në paketim dhe në trupin e tonerave/bojërat, siç aplikohet nga prodhuesi. Kodi tonerit/dramit i pasqyruar në paketim, duhet të korrespondojë me kodin e pasqyruar në trupin e tonerit/dramit.

Argumentim: *Në bazë të pikës 4, neni 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe pika 8 e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" (i ndryshuar), me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të deklarojnë këtë fakt me qëllim krijimin e sigurisë dhe garancisë për Autoritetin Kontraktor që malli me të cilin do*

furnizohet ky i fundit, ti përshtatet llojeve dhe pajisjeve të printimit dhe fotokopjimit.

2.3.4 Operatori ekonomik të paraqesë një Deklaratë ku të marrë përsipër që mallrat do të dorëzohen të ambalazuara si më poshtë:

- Të jenë të mbështjella në qese në mënyrë hermetike dhe të pahapura (duke plotësuar kushtet e ruajtjes së sigurtë) dhe të ambalazuara nëpër kuti, të shoqëruara me pulla sigurie nga prodhuesi.

Shënim: *Ambalazhimi luan një rol të rëndësishëm në reduktimin e rreziqeve të sigurisë së produktit. Ambalazhet duhet të jenë lehtësisht të identifikueshme, të kenë emrin e markës në ambalazh dhe në trup, të kenë elementët e sigurisë të padëmtuara*

Argumentim: *Në bazë të nenit 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pika 8 e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të deklarojnë se artikujt objekt prokurimi janë në përputhje me specifikimet teknike të kerkuar nga Autoriteti Kontraktor. Gjithashtu me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të deklarojnë këtë fakt me qëllim krijimin e sigurisë dhe garancisë për Autoritetin Kontraktor që malli me të cilin do furnizohet ky i fundit, ti përshtatet llojeve dhe pajisjeve të printimit dhe fotokopjimit.*

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të se ciles merr përsipër të kryejë shërbimin e transportit, të gjithë artikujve.

Argumentim: *Në bazë të pikës 4, neni 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pika 8 e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të deklarojnë se do të kryejnë transportin e mallrave objekt prokurimi në adresën e autoritetit kontraktor, sa herë të lidhet kontratë ndërmjet palëve kontraktore.*

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalog/broshurë ose fragment katalogu ose broshurë nga prodhuesi ose distributori i autorizuar prej tij, për të gjithë artikujt e tjere (përveç ato të kerkuar si mostra), i cili duhet të përmbajë minimalisht keto të dhëna: artikull nr., emertimi, prodhuesi, ngjyra, kodi i produktit, numri i faqeve, foto ose linku ku mund të gjenden të dhënat e artikullit. Në rastin kur katalog/broshurë nuk është në gjuhën shqipe, duhet të jetë i perkthyer në gjuhën shqipe dhe i noterizuar.

Argumentimi: *Vendosja e kriterit të sipërcituar është vënë në mbështetje të nenit 40 pika 6 gërma b) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar parashikohet shprehimisht: Autoriteti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: b) fotografitë apo katalogjet teknike. Paraqitja e katalogëve të prodhuesve është e nevojshme në funksion të verifikimit të përputhshmërisë së produkteve me specifikimet teknike të*

AK me qëllim realizimin e kontratës me sukses. Paraqitja e katalogjeve per zerat e mallrave, eshte kerkuar me qellim verifikimin e perputhshmerise se mallrave qe operatori ekonomik oferton, me specifikimet teknike te percaktuara ne DST.

2.3.7 Operatorët Ekonomikë pjesemarrës duhet të paraqesin mostrat (kampionet) për disa prej artikujve te kerkuar si më poshtë, në ditën e hapjes së ofertave, në orën dhe vendin e caktuar në dokumentat e tenderit:

- **Artikulli Nr.5 : Canon irADV 400 – Toner C-EXC 43 ose ekuivalent**
- **Artikulli Nr.17 : Canon LBP6780 – Toner 724H ose ekuivalent**
- **Artikulli Nr.18 : Canon LBP3460 – Toner 710H ose ekuivalent**
- **Artikulli Nr.27 : Lexmark B2338 – Toner B232000 ose ekuivalent**
- **Artikulli Nr.45 : Pantum 7100DW – Toner TL-410X ose ekuivalent**
- **Artikulli Nr.43 : Pantum 5100DW– Toner TL-5120X ose ekuivalent**
- **Artikulli Nr.23 : HP LaserJet MFP M527m – Toner CF287X ose ekuivalent**

Shënim: Mosparaqitja e mostrave sipas kërkesave të mësipërme përbën kusht s’kualifikimi për vazhdimin e procedures.

- *Mostrat e kërkuara duhet të kenë një etiketë të ngjitur, e cila do të përmbajë: mostër “emri i artikullit”, numrin rendor sipas ofertës së paraqitur, objektin dhe datën e zhvillimit të tenderit, emrin e ofertuesit, nënshkrimin dhe vulën e operatorit ekonomik ofertues.*
- *Mostrat duhet të jenë në përputhje me të gjitha specifikimet teknike të kërkuara.*
- *Mostrat do te dorezohen perpara komisionit, ne oren dhe daten e percaktuar per hapjen e ofertave, pranë Bashkisë Kamëz.*

Argumentimi: *Referuar VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit public” neni 40 pika 6 është përcaktuar se: Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Artikujt per te cilet kerkohen mostra jane materiale konsumi qe ndikojne drejtperdrejt ne performancen dhe jetegjatesine e pajisjeve; ne cilesine e printimit; ne kostot e mirembajtjes se institucionit.*

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

ARGUMENTIMI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Specifikimet teknike dhe fondi limit jane percaktuar nga komisioni i ngritur me Urdhër të titullarit te autoritetit kontraktor.

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

NJESIA E PROKURIMIT